



REPUBLIKA E SHQIPERISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT MJEDISOR

Nr. 4983 Prot.

Tiranë, më: 08.05. 2019

Nr. Identifikimi 379

Vendimi 22

REFUZIM DEKLARATE MJEDISORE

Në mbështetje të Ligjit Nr. 12/2015 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", VKM Nr. 686, datë 29.7.2015 "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore, dhe me propozim të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Ministri

VENDOSI :

Mos pajisjen me Deklaratë Mjedisore për **Zhvilluesin** me të dhënat si më poshtë:

Personi juridik: "FERA STONE" sh.p.k.

Nr. NIPT-i: L76513005M

Adresa e selisë: Lagjia "3 Heronjtë", Rr. "Dora D'Istria", Nr. 3, Shkodër

Personi përgjegjës: Bardhok Vata

Për të zhvilluar projektin "**Shfrytëzim i minerlit gëlqerorit të mermerizuar**"

Aplikimi është bërë referuar ligjit Nr. 10 440, datë 7.7.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", Shtojca I, "Projektet që i nënshtrohen Procedurës së Thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis", Pika 19. Gurore dhe miniera sipërfaqësore, ku sipërfaqja e vendit është mbi 0,5 hektarë, ose vende për nxjerrjen e torfës, ku sipërfaqja e vendit është mbi 1 hektar.

Vendndodhja: Zona Minerare 2016, Objekti Vuksanaj, Shkodër

(Bashkangjitur Anex 1 Harta dhe koordinatat)

Bazuar në pikën 2 të nenit 12 të ligjit nr. 10440, datë 07.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, më poshtë po listojmë:

I. Qëndrimin e Drejtorive Teknike:

Drejtoritë teknike të ministrisë shprehin mendimin si më poshtë vijon:

- Në raportin e thelluar të Vlerësimin të Ndikimit në Mjedis të reflektohet legjislacioni në fushën e mbetjeve;
- Të mbahen parasysh kërkesat e nenit 38, ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”;
- Mbetjet inerte që do të gjenerohen të trajtohen sipas kërkesave të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”;
- Mbetjet që do të krijohen të specifikohen sipas kodit të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 99, datë 18.2.2005, “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve” të ndryshuar;
- Informacion mbi vajrat e përdorura të makinerive, të cilat klasifikohen si mbetje të rrezikshme. Të trajtohen sipas kërkesave të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 765, datë 07.11. 2012 “Për rregullat dhe procedurat për asgjësimin e vajrave të përdorur”;

Të jepet informacion i zgjeruar në raport, rreth:

- a. sasisë së gjenerimit të mbetjeve,
 - b. trajtimit të mbetjeve;
 - c. transportimit të mbetjeve
 - d. asgjësimit të mbetjeve, sipas kërkesave e akteve të sipërcituar dhe akteve të tjera ligjore në fuqi;
- Sugjerojmë që të merret mendimi i Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura.

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura shprehet:

Referuar raportit teknik dhe koordinatave të paraqitura nga subjekti, sipërfaqja ku kërkon të zhvillohet aktiviteti, ndodhet në monumentin e natyrës (MN) “Porta e Shalës”, shpallur me Nr. 676, datë 20.12.2002 “Për shpalljen zonë e mbrojtur të monumenteve të natyrës shqiptare”, kategoria e III e zonave të mbrojtura.

Bazuar në ligjin nr. 81, datë 04.05.2017, neni 17, pika 2 citohet se: “Në një “Monument natyre” zbatohet shkalla e mbrojtjes, e njëjtë me “Rezervën strikte”. Zona mbrohet e menaxhohet për ruajtjen e karakteristikave dhe dukurive të veçanta natyrore, kulturore, historike e arkeologjike, për të cilat është shpallur monument”.

Përsa më sipër cituam, shprehem kundër zhvillimit të këtij aktiviteti.

2. Arsyet dhe konsideratat kryesore, ku është mbështetur mendimi:

Duke marrë në konsiderat zonën ku do të ushtrohet aktiviteti, gjykojmë se ky projekt shkakton ndikime të rëndësishme negative me pasoja afatgjata, që dëmtojnë cilësinë e mjedisit dhe nuk mundësojnë përmbushjen e standardeve mjedisore përkatëse.

DREJTORI I PËRGJITHSHËMI AKM


EDISON KONOMI

MINISTRI



BLENDI KLOSI



1. Anex 1. Harta dhe koordinatat

Leja Minerare Nr. (zona216)

INSTITUTI QENDRORE I GJEKMIT
 KOMBETARE



MINISTRIA E INFRASTRUKTURES DHE ENERGJISE DREJTORIA E PROGRAMEVE TE ZHVILLIMIT TE INDUSTRISE DHE ENERGJISE OBJEKTI "Vuksana", Qarku Shkoder		Koordinatat		
		Pika	X	Y
Zona nr.	216	1	4685270	4400755
Minerali	Celqeror i mermerizuar	2	4684550	4401625
Lloji i lejes	Shfrytezim	3	4684240	4401440
Siperfaqja, km ²	0.884	4	4684800	4400800
Meritan Aleksi	data firma	5	4684150	4399600
	25.06.2018	6	4684425	4399440